



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 354/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV) dega në Dardanë, paraqitur kundër subjektit politik G.I. Srpska, dega në Dardanë, për shkak të vendosjes së posterit në shenja publike të trafikut, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë, kështu që subjektit politik G.I. Srpska, dega në Dardanë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 550 (pesëqindpesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 26.10.2013, nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 26.10.2013, në fshatin Stralic Komuna e Dardanës, anëtarë të subjektit politik Srpska, kanë vendosur posterë nga ky subjekt mbi shenja të komunikacionit. Parashtruesi i ankesës me këtë rast konsideron se është bërë shkelje e Nenit 33 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), dhe neni 4.1 pika b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës foto si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik G.I. Srpska, në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 28.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 29.10.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP- i mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik G.I. Srpska, në të cilën theksohet se fotografitë e bashkangjitura nuk paraqesin dëshmi se aktivistet e G.I. Srpska, kanë vendosur postere, aktivistet e G.I. Srpska janë njoftuar dhe rreptësisht janë duke i respektuar të gjitha rregullat zgjedhore, poashtu në përgjigje theksohet se nuk ekziston apo nuk është paraqitur ndonjë dëshmi si audio apo video inqizim ku shihet se aktivistet e G.I. Srpska kanë vendosur postere në shenja të trafikut, ndërsa deri tek materiali zgjedhor mund të vihet në mënyra të ndryshme të keqpërdorimit, si me shtypjen e paautorizuar dhe kështu mund të shkaktohet drejtpërdrejt dëmi i subjektit tjetër politik. Gjithashtu G.I. Srpska thekson se nuk ka paraqitur listën e kandidatëve për komunën e Kamenicës, dhe se në këtë komunë nuk jemi duke zhvilluar fushatën zgjedhore, kështu që nuk është në interesin tonë që aktivistet e G.I. Srpska të vendosin postere në komunën e Kamenicës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Sipas pretendimeve ankimore, anëtarë të subjektit politik G.I. Srpska, kanë vendosur posterë të këtij subjekti në shenja publike të trafikut, i cili veprim është në kundërshtim me neni 33 pika b) të LZP, neni 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, të cilat përcaktojnë

veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që kanë të bëjnë me vendosjen e njoftimeve, pllakateve, dhe posterëve ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në shenja publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës identifikohet qartë se posterë nga subjekti G.I Srpska janë vendosur në shenja publike të trafikut, një veprim të tillë PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat e sipërshënuara ligjore.

Ndërsa pretendimet në përgjigjen e ankesës nga subjekti politik G.I.Srpska se fotografitë e bashkangjitura nuk paraqesin dëshmi se aktivistet e G.I.Srpska i kanë vendosur këto postere, nuk ekziston ndonjë audio apo video incizim ku shihet se këta aktivistë i kanë vendosur posteret në shenja publike të trafikut, dhe se nuk është në interesin e tyre të vendosin postere për shkak se sipas tyre G.I.Srpska nuk ka paraqitur listën e kandidatëve për Komunën e Kamenicës, dhe se nuk jemi duke mbajtur fushatë zgjedhore, subjekti politik G.I.Srpska përveç këtyre thënieve në përgjigje në ankesë, nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi, që kërkohet sipas nenit 32.6 të LZP-së, se subjekti në fjalë ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar ose dekurajuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët nga shkelja e këtij Kodi. Këto dëshmi mund të përdoren në përcaktimin e masave të mëtejshme.

Prandaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e G.I.Srpska, është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase janë vendosur posterë në shenja publike të trafikut, të cilët i takojnë subjektit G.I Srpska, dhe se subjekti politik në fjalë nuk ka bërë asnjë përpjekje serioze për të parandaluar veprimet e tilla, me qëllim të evitimit të shkeljeve të sipërshënuara, po ashtu subjekti i njëjtë politik ka bërë shkelje të kësaj natyre edhe më herët në këto zgjedhje dhe në këtë rast konsiderohet si recidivist, pasi që edhe më parë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LZP-së, PZAP, e mori si rrethanë rënduese për rritjen e dënimit, si dhe duke marrë parasysh faktorët e cituar me lartë, për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa në Prishtinë

Anr. 354/2013 më datën 31.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*